

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM
Nr. 237, dt. 17.11.2015

Në mbështetje të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 17.11.2015, pasi shqyrtoi relacionin mbi gjetjet në Amfiteatrin e Durrësit në kuadër të zbatimit të projektit *"Rehabilitimi i hapësirës së Amfiteatrit të Durrësit"*, të diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Të dokumentohen, ruhen dhe konsolidohen fragmentet e mureve të zbuluara, të cilat i përkasin monumentit të Amfiteatrit të Durrësit.
2. Të kryhet dokumentimi i fragmentit të murit të banesës së shek. IX-XX dhe më pas të vijohet me çmontimin e kësaj strukture, për të vijuar me projektin e zbatimit *"Rehabilitimi i hapësirës së Amfiteatrit të Durrësit"*
3. Të dokumentohet porta në formë “harku triumfi”, me ornamente floreale, por çmontimi e saj të bëhet në një fazë të dytë.
4. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

